

Njoftim për vend vakant pune

Shoqëria “Albpetrol SH.A”, shoqëri me pronësi publike, e cila operon në fushën e kërkimit, nxjerrjes dhe marketimit të naftës dhe gazit, kërkon të punësojë në pozicionin “**Specialist për Dokumentimin e Fondit Gjeologjik në Qendrën e Prodhimit të Naftës Gorisht**” 1 (një) kandidat profesionist në fushën e inxhinierisë së naftës, i cili duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

Aftësitë e kërkuara:

Arsimimi	<ul style="list-style-type: none">• Diplomë në Inxhinieri Naftë profili Gjeologji në një nga universitetet e akredituara në vend apo në universitete të tjera të huaja.• Diplome Master dhe certifikata të njohura në fushën e inxhinierisë.
Eksperiencë pune	<ul style="list-style-type: none">• Preferohet të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune si Inxhinier Gjeologjik në sektorin e naftës.• Të paraqesë Letra Reference nga punëdhënësit e mëparshëm.
Cilësitë	<ul style="list-style-type: none">• Njohuri të mira për shoqëritë tregtare, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.• Aftësi për të planifikuar, menaxhuar, ndjekjen e detyrave dhe komunikimi në të gjitha nivelet e Shoqërisë Anonime;• Aftësi për të trajtuar informacion konfidencial në mënyrë të ndjeshme;• Aftësi për të kryer shumë detyra, për të punuar nën presion dhe për të përmbushur afatet e kërkuara.• Nivel i lartë integriteti dhe besueshmërie me një ndjenjë të fortë efikasiteti dhe orientimi të rezultateve.

Kandidatet që plotësojnë kushtet e mësipërme dhe që dëshirojnë të aplikojnë duhet të dërgojnë kërkesën e tyre, së bashku me CV; Fotokopje e Diplomës; Fotokopje e librezës së punës, dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. ose në adresën bnj@albpetrol.al

Kërkesat pranohen deri më datën 22 Dhjetor 2020, ora 15:00.

Personat e përzgjedhur do të kontaktohen nga shoqëria Albpetrol sh.a.